



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

CAP.nr.1146/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, gjykatësi individual Dr.sc. Rafet Haxhaj, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen përmbarimore të kreditorit "..." SHPK, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson "D...", Prishtinë, kundër debitorit G. Sh, Prishtinë, lidhur me pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.113/2023 të datës 15.05.2023, me datë 04.04.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e kreditorit "M..." SHPK, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.113/2023 i datës 15.05.2023, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit G. Sh nga Prishtina, i ushtruar kundër urdhrit P.nr.47/23 të datës 13.02.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat S. A me seli në Gjilan, me të cilën është lejuar propozimi i kreditorit "M..." Sh.p.k me seli në Prishtinë, lidhur me pagesën e borxhit në vlerë prej 1,264.73 €, mbi bazën e Kontratës së Kredisë nr.AG5454211 të datës 15.11.2019, Marrëveshjen e Pengut dhe Konfirmimi i Regjistrimit me nr.R-20221107-558. Në pikën II., të dispozitivit shfuqizohet - Urdhri P.nr.47/23 i datës 13.02.2023, i lejuar nga përmbaruesi privat S. A. me seli në Gjilan.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që Gjykata e Apelit të anuloj Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me nr. PPP.nr.113/2023 të datës 15.05.2023 dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se kreditori "M..." SHPK, me seli në Prishtinë, ka parashtruar propozimin për përmbaram me datë 13.02.2023, në bazë të Kontratës së Kredisë nr. AG5454211 të datës 15.11.2019, Marrëveshjes së Pengut dhe Konfirmimit të Regjistrimit me nr. R-20221107-558.

Përmbaruesi privat S. A me Urdhër Përmbarimore P.nr.47/23 të datës 13.02.2023, e ka lejuar përmbaramin në mes të kreditorit "M..." SHPK ndaj debitorit G. Sh, për shkak të mos pagesës së borxhit në vlerë 1,264.73, në bazë të dokumentit – Kontrata e Kredisë me nr.AG54542111 i datës 15.11.19, Marrëveshjen e Pengut e datës 15.11.19 dhe Konfirmimin e Regjistrimit me nr.R-20221107-558.

Kundër urdhrit përmbaramor P.nr. 47/23 të datës 13.02.2023, prapësim ka paraqitur debitori, i cili ka theksuar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar kërkesën e kreditorit, për faktin se kreditori nuk i ka njoftuar për mos pagesë të këstit/borxhit, pas heqjes së licencimit të kreditorit nga Banka Qendrore e Kosovës.

Kreditori, brenda afatit ligjor, ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, me të cilën ka kërkuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar dhe të vazhdohet me procedurën e përmbaramore ndaj debitorit.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar me ankesë.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe gjykatësi i vetëm i Gjykatës së Apelit për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës dhe se me rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka marr vendim të drejtë kur ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit e kështu duke shfuqizuar urdhrin për përmbaram P.nr.47/23 të datës 13.02.2023. Gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë, gjen se, qëndron arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë se dokumentet përmbaramore nuk i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 36 të LPP-së ngase dokumentet përmbaramore në bazë të të cilave është kërkuar përmbarami si: Marrëveshja e linjës së kredisë nr. AG5454211 i datës 15.11.2019, Marrëveshja e Pengut dhe konfirmimi i regjistrimit me nr. R-20221107-558 janë dorëzuar në kopje të pa vërtetuara. Gjyqtari individual vlerëson se dokumentet e lartcekura në bazë të cilave është lejuar përmbarami janë dorëzuar në kopje të pa vërtetuara nga ana e kreditorit. Neni 36 paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Përmbaramore përcakton se: *"Së bashku me propozimin për përmbaram, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, **original apo kopje e vërtetuar**".* Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë, gjyqtari individual ka vendosur që pretendimet ankimore të

kreditorit të refuzohen si të pa bazuara, ndërsa aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjykatësit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjykatësi individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 par.1 pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 3.2 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CAP.nr.1146/2023, me datë 04.04.2024

GJYKATËSI,  
Dr.sc. Rafet Haxhaj